

RELACION

I PROJEKTLIGJIT

“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.162/2014 “PËR MBROJTJEN E CILËSISË SË AJRIT NË MJEDIS¹”, I NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Menaxhimi, monitorimi dhe mbrojtja e cilësisë së ajrit në Republikën e Shqipërisë përbën një prioritet strategjik, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në kuadër të procesit të integrimit evropian. Kuadri aktual ligjor, i përcaktuar nga ligji nr.162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” *i ndryshuar*, kërkon përmirësim të mëtejshëm për të siguruar përputhshmëri të plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian.

Ky ligj është përafuar me:

- **Direktivën (BE) 2024/2881 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit**, datë 23 tetor 2024, “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër për Evropën”, Numri CELEX 32024L2881, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L.
- **Direktivën (BE) 2016/2284 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit**, datë 14 dhjetor 2016, “Për reduktimin e emetimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë (Direktiva NEC)”, Numri CELEX 32016L2284, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 344, datë 17.12.2016.
- **Direktivën 1999/13/EC të Këshillit**, datë 11 mars 1999, “Për kufizimin e emetimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC) që rezultojnë nga përdorimi i tretësve organikë në disa aktivitete dhe instalime”, Numri CELEX 31999L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 85, datë 29.3.1999.
- **Direktivën 2004/42/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit**, datë 21 prill 2004, “Për kufizimin e emetimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC) për shkak të përdorimit të tretësve organikë në disa bojëra dhe llaqe dhe në produktet për rifinurimin e automjeteve”, Numri CELEX 32004L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 143, datë 30.4.2004.
- **Akte të tjera të Bashkimit Europian që lidhen me cilësinë e ajrit, emetimet në ajër dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit.**

Në këtë kontekst, projektligji synon transpozimin e pjesshëm në legjislacionin shqiptar të Direktivës 2024/2881/KE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2024, “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër për Evropën, duke vendosur një kuadër të qartë për menaxhimin dhe monitorimin e cilësisë së ajrit në mjedis. Transpozimi i plotë i Direktivës 2024/2881/KE në legjislacionin shqiptar do të arrihet më tej më miratimin e dy vendimeve të Këshillit të Ministrave që parashikohen të propozohen nga ministri përgjegjës për mjedisin, në zbatim të projektligjit të propozuar

Përmes këtyre ndryshimeve, projektligji synon të krijojë një sistem më efektiv dhe të integruar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, duke forcuar përgjegjësinë e institucioneve publike dhe përfshirjen e publikut, si dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit, mjedisit në përgjithësi dhe të jetës së qytetarëve, në përputhje me standardet dhe objektivat e Bashkimit Evropian.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Kapitulli i mjedisit është një nga kapitujt e rëndësishëm në kuadër të procesit të integritit, detyrimet e të cilit përcaktohen në nenin 70/3 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që parashikon domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit vendas me “*acquis communautaire*”. Për shkak të rëndësisë që ka mbrojtja e mjedisit, MSA-ja përmban një nen të posaçëm për mjedisin, Nenin 108, ku përcaktohet bashkëpunimi në luftën kundër degradimit mjedisor me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore, nëpërmjet përafrimit me (Acquis e BE-së) në fushën e mjedisit.

Miratimi i këtij projektligji është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Akteve të Ministrisë së Mjedisit dhe Programin Kombëtar të Integritit European (PKIE) për vitin 2026, dhe është në përputhje edhe me Programin Politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.162/2014 1 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit”, i ndryshuar”

Fusha e mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi dhe mbrojtja e cilësisë së ajrit në vecanti në Republikën e Shqipërisë ka pësuar zhvillime të rëndësishme gjatë viteve të fundit, në funksion të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”. Megjithatë, kuadri aktual ligjor, i përcaktuar nga ligji nr.162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” i ndryshuar, paraqet boshllëqe dhe mangësi në lidhje me monitorimin e cilësisë së ajrit, përcaktimin e metodologjive dhe zbatimin masave në rastet e tejkalimit të niveleve të përcaktuara të ndotësve.

Në mënyrë të veçantë, legjislacioni ekzistues nuk siguron një transpozim të plotë dhe të qartë të Direktivës 2024/2881/KE “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër për Evropën”, duke sjellë mangësi dhe boshllëk ligjor në aspekte si:

- a) **vlerat limit**, te cilat bazohen ne direktivën e vjetër. Legjislacioni aktual në fuqi mbështetet ende në vlerat e vjetra të direktivave 2004/107/KE dhe 2008/50/KE, ndërkohë që direktiva e re kërkon standarde shumë më të rrepta;
- b) **monitorimi**, nga ku aktualisht monitorimi i cilësisë së ajrit mbetet i përqendruar kryesisht në Tiranë, me stacione që matin kryesisht PM10, PM2.5 dhe NO2 të lidhura me trafikun. Direktiva e re kërkon supersite ,shton listën e ndotësve si dhe përcakton një mbulim gjeografik më të gjërë nga ku përveç zonave urbane përfshin edhe ato me sfond rural;
- c) **modelimi**, pasi legjislacioni aktual nuk parashikon detyrim për modelim atmosferik por fokusohet në vlerësimin nëpërmjet matjeve direkte, pa e bërë modelimin element të detyrueshëm të sistemit të vlerësimit. Ndërkohë Direktiva 2024/2881/KE e bën modelimin të detyrueshëm, veçanërisht aty ku tejkalohe vlerat limite.

Efektet e pritshme të këtij projektligji janë të shumëfishta dhe lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e menaxhimit të mbrojtjes së cilësisë së ajrit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

Ndër efektet e pritshme të projektligjit, veçanërisht e rëndësishme është rritja e efektivitetit në monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së ajrit dhe parandalimin e tejkalimit të vlerave kufi të ndotësve. Paralelisht, pritet të përmirësohet ndjeshëm menaxhimi i mbrojtjes së ajrit në mjedis, duke krijuar një sistem më të integruar dhe të qëndrueshëm institucional. Projektligji synon gjithashtu të forcojë transparencën në raportimin mjedisor dhe të zgjerojë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, duke i dhënë qytetarëve rol aktiv në çështjet që prekin drejtpërdrejt mjedisin dhe shëndetin e tyre. Në tërësi, këto ndryshime priten të

sjellin një përmirësim të prekshëm të cilësisë së ajrit dhe, për rrjedhojë, të kontribuojnë në ngritjen e standardit të jetesës së të gjithë qytetarëve. Në tërësi, projektligji përbën një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e mjedisit, duke adresuar mangësitë ekzistuese dhe duke krijuar bazat për një sistem më të qëndrueshëm dhe efektiv të mbrojtjes së cilësisë së ajrit dhe për një ajër më të pastër në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji u publikua në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP) nga data **xx.03.2026 deri me datë xx.xx.2026**.

Ky projektligj është diskutuar edhe në disa dëgjesa publike gjatë të cilave u prezantuan pikat kryesore të projektligjit, u zhvilluan diskutime dhe u mblodhën sugjerimet e pjesmarrësve dhe konkretisht:

- i. Dëgjesa publike e datës xx.xx.2026 **me organizatat mjedisore.**
- ii. Dëgjesa publike e datës xx.xx.2026 **me xxxxxx.**
- iii. Dëgjesa publike e datës xx.xx.2026 **me xxxxx.**
- iv. Dëgjesa publike e datës xx.xx.2026 **me xxxxx.**

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe është harmonizuar me Kodin e Procedurave Administrative, me legjislacionin në fuqi për mjedisin dhe me legjislacionin për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

- Projektligji synon një përafrim të pjesshëm Direktivën (BE) 2024/2881 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2024, “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër për Evropën”, Numri CELEX 32024L2881, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L.
- Direktivën (BE) 2016/2284 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 dhjetor 2016, “Për reduktimin e emetimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë (Direktiva NEC)”, Numri CELEX 32016L2284, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 344, datë 17.12.2016.

Relation shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.162/2014 l “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit”, i ndryshuar”

- Direktivën 1999/13/EC të Këshillit, datë 11 mars 1999, “Për kufizimin e emetimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC) që rezultojnë nga përdorimi i tretësve organikë në disa aktivitete dhe instalime”, Numri CELEX 31999L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 85, datë 29.3.1999.
- Direktivën 2004/42/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 21 prill 2004, “Për kufizimin e emetimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC) për shkak të përdorimit të tretësve organikë në disa bojëra dhe llaqe dhe në produktet për rifiniturimin e automjeteve”, Numri CELEX 32004L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 143, datë 30.4.2004.
- Akte të tjera të Bashkimit European që lidhen me cilësinë e ajrit, emetimet në ajër dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban gjithsej 7 nene, si dhe përmban gjithashtu 3 shtojca.

NENI 1, parashikon zgjerim të përkufizimeve duke shtuar një sërë konceptesh të reja ligjore që mungonin në ligjin aktual, të nevojshme për harmonizim me direktivën evropiane.

NENI 2, zgjeron fushën e zbatimit të vendimit të këshillit të ministrave duke shtuar edhe monitorimin si një nga kërkesat kryesore të direktivës.

NENI 3, përcakton parashikimet ligjore mbi Strategjinë Kombëtare, Planet e cilësisë së ajrit dhe Udhërrëfyesin për cilësinë e ajrit. Ky është neni më substantiv i projektligjit duke qenë se rregullon të gjithë kuadrin e planifikimit strategjik.

NENI 4, i cili parashikon detyrimet e reja mbi informimin e publikut nga ku shtohen dhe dy detyrime të reja për autoritetin përgjegjës.

NENI 5 i cili shton detyrimin për Ministrinë që të identifikojë çdo vit zonat ku ndotja e ajrit vjen nga shtetet fqinje dhe kontribuon në tejkalimin e vlerave kufi si dhe parashikohet edhe bashkëpunimi ndërkufitar për krijimin e stacioneve të përbashkëta monitorimi me vendet fqinje dhe shkëmbimin e të dhënave.

NENI 6, i cili është dispozita më e re dhe inovative e projektligjit. Për herë të parë njih të drejtën ligjore të qytetarëve për kompensim kur autoritetet shkelin me dashje ose nga pakujdesia rregullat e mbrojtjes së ajrit dhe kjo shkakton dëme shëndetësore. Rregullat procedurale do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 7, forcon të drejtën e publikut të interesuar dhe organizatave mjedisore për të kundërshtuar ligjshmërinë e vendimeve administrative lidhur me vendndodhjen e stacioneve të monitorimit dhe planet e cilësisë së ajrit. AKM (Agjencia Kombëtare e Mjedisit) ka detyrimin të shqyrtojë kërkesat dhe të informojë publikun për vendimin e marrë.

SHTOCJAT – Siç u përmend edhe më sipër projektligji për disa ndryshime në ligjin 162/2014 “Për Mbrojtjen E Cilësisë Së Ajrit Në Mjedis”, i ndryshuar ka 3 shtojca, që rregullojnë aspektet më teknike të dispozitave ligjore.

Shtojca I, përmban Listën e Ndotësve të Ajrit duke I klasifikuar ato në pesë grupe:

- Grupi I — vlera kufi të detyrueshme: SO₂, NO₂, NO_x, PM₁₀, PM_{2,5}, Pb
- Grupi II — vlera të synuara: Ozoni (O₃)
- Grupi III — ndotës të tjerë: Benzeni, CO, PAH/BaP
- Grupi IV — metale të rënda: As, Cd, Ni, Hg
- Grupi V — ndotës të rinj për monitorim: Amoniaku (NH₃) dhe NMVOC

Shtojca 2, përcakton parashikimet përsa I përket Përmbajtjes së Planeve të Cilësisë së Ajrit duke detajuar informacionin e detyrueshëm në planet e cilësisë së ajrit, burimet, skenarin bazë, masat e mundshme dhe të zgjedhura, afatet, vlerësimet e ndikimit, si dhe listë orientuese masash (transport, industri, bujqësi, ndërtim, sjellja e konsumatorëve).

Shtojca 3, Informimi i Publikut e cila përcakton detyrimin për informim të rregullt dhe në kohë reale mbi cilësinë e ajrit, duke përfshirë të dhëna orare, ndikime shëndetësore, tejkalime të vlerave kufi dhe parashikime. Informacioni duhet të jetë i aksesueshëm nëpërmjet faqeve zyrtare, aplikacioneve mobile dhe mediave.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.162/2014 1 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit”, i ndryshuar”

Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij ligji.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Mjedisit me asistencën e ekspertëve të Projektit Environment Support Programme Albania

Projektligji u dërgua për mendim nëpërmjet sistemit e-akte tek

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin 162/2014 “Për Mbrojtjen E Cilësisë Së Ajrit Në Mjedis”, i ndryshuar sjell detyrime financiare të cilat në mënyrë të detajuar janë analizuar tek dokumenti i RIA-s për këtë projektligj, i hartuar me asistencën e ekspertëve të Projektit Environment Support Programme Albania dhe i vlerësuar nga Drejtoria e RIA-s pranë Këshillit të Ministrave.

Projektligji nuk parashikon shpenzime shtesë për buxhetin e shtetit. Megjithatë, për dispozitat që kërkojnë miratimin e akteve nënligjore, në veçanti për përcaktimin e metodave për vlerësimin e kostove, sigurimin e fondeve, garancive apo siguracioneve për rehabilitimin e dëmit mjedisor, do të kryhet një vlerësim i detajuar financiar në fazën e hartimit dhe miratimit të vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.

MINISTRI

Sofjan JAUPAJ